Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/187
Datë 13.07.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 13.07.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e American College in Kosovo Foundation në Prishtinë, për periudhën 3 vjeçare, prej 13. 07. 2015 deri 13. 07. 2018 për këtë kualifikim të aprovuara:

1.1. Teknologji Informative dhe e Komunikimit, niveli i KKK-së (II).

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të ofrohet dëshmi për zgjatjen e afatit të marrëveshjes me KK të Prishtinës për shfrytëzim të objektit.
- Të ofrohet dëshmi për licencimin e AUK TDI nga ana e ECDL Kosovës për vitin 2015.
- Salla e kompjuterëve ka 20 kompjuter për nevoja të kandidatëve, një kompjuter për nevoja të trajnerit/instruktorit, një projektor, një panel për projektim dhe një tabelë pune. Në bazë të kësaj duket e ngushtë për të akomoduar të gjitha këto; shto këtu edhe numrin e pjesëmarrësve prej 20 vetave. Konform etikës profesionale të hapësirave të trajnimit, tepihu në dysheme dhe vështirësitë që në rreshtin e majtë, respektivisht të djathtë hasin kandidatet gjatë uljes në kompjuterët respektiv janë tregues se ka nevojë për përmirësim të kësaj hapësire.

- Rekomandohet që të ketë procedurë të shkruar për mënyrën se si realizohet procesi i kopjeve rezervë, kush ka qasje në ato të dhëna çfarë masash janë marrë për të qenë të sigurta?
- Të dhënat personale të mbledhura nga kandidatët ruhen me konfidencialitet të lartë, megjithatë, kërkohet që në formularët në linjë apo në letër të shënohet ligji për ruajtjen e të dhënave në R. e Kosovës.
- Konform praktikës në arsimin sipëror dhe profesional, rekomandohet që instruktori të mos ketë angazhime trajnimi më shumë se 4 orë në ditë.
- Rekomandohet që në raportin e vetë-vlerësimit krahas shtyllës së vlerësimit (notës) të ofrohen edhe dëshmi. Pra shtylla e dëshmisë të mos lihet e zbrazët!
- Meqë AUK TDI është një vatër e mirëfilltë e diturisë profesionale, me këtë edhe ambienti punues i organizatës në fjalë në baza ditore është i stërmbushur, pjesëmarrësit e trajnimit të TI-se nuk dallohen nga nëpunësit e organizatës. Kjo vë në pah faktin që medoemos duhet të vendoset një standard ne identifikimin e nëpunësve nga pjesëmarrësit.
- Rekomandohet që AUK TDI të vendos personelin i cili do të merret ekskluzivisht me sigurimin e cilësisë.

  (Afati kohor: 01. 10. 2015)

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 02.03.2015, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:
   - American College in Kosovo Foundation në Prishtinë; dhe
   - AKK.

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani